

Shpjegim i "Libri i teuhidit" – 65

(E drejta e Allahut ndaj njerëzve)

Mësimet të mbajtura nga dijetari i njohur Salih Ibn Abdul Aziz Muhamed Ali Shejh

(Allahu e faltë atë, prindërit e tij dhe të gjithë muslimanët!)

Përkthyes: Bilbil Talla

Redaktor: Ilir Haxhiaj

Kapitulli: Kurrë nuk i kërkohet Allahut të ndërmjetësojë te krijesat e Tij

Xhubejr Ibn Mutimi tregon: “Njëherë, një beduin shkoi tek Profeti i Allahut (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) dhe i tha: “Trupat na janë dobësuar, familjet i ka pllakosur uria, pasuria po na shkatërrohet, prandaj kërkoi Zotit tënd të na sjellë shi. Ne i kërkojmë Allahut të ndërmjetësojë tek ti dhe të kërkujmë ty të ndërmjetësosh tek Allahu”. Profeti tha: “Subhanallah, Subhanallah!”. Vazhdoi të thoshte “Subhanallah”, derisa ajo u duk në fytyrat e shokëve të tij. Pastaj tha: “I mjeri ti! A e di ti kush është Allahu? Me të vërtetë, pozita e Allahut është më e madhe. Nuk i kërkohet Allahut që të ndërmjetësojë tek asnjëra nga krijesat e Tij”¹.

Dobitë e temës

- Kundërshtimi që Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) bëri atij që tha: “Ne i kërkujmë Allahut të ndërmjetësojë tek ti”.
- Ndryshimi i gjendjes së Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!), e cila u pasqyrua edhe në fytyrat e shokëve të tij nga ajo kërkesë.
- Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) nuk e kundërshtoi pjesën tjetër të kërkesës së beduinit: “... dhe të kërkujmë ty të ndërmjetësosh tek Allahu”.
- Komenti i shprehjes: “Subhanallah”.
- Muslimanët i kërkuan Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) të lutej për shi.

Kapitulli: “Kurrë nuk i kërkohet Allahut të ndërmjetësojë te krijesat e Tij”.

“*La justeshfaë*”, domethënë nuk kërkohet që të bëhet Allahu ndërmjetësues tek krijesat e Tij, sepse pozita e Allahut të Lartësuar është më e madhe dhe më e lartë sesa të jetë ndërmjetësues, që të përfitojë ndonjë nga krijesat.

Ndërmjetësimi i njohur është: t’i shkosh dikujt dhe t’i kërkosh që ai të ndërmjetësojë tek dikush tjetër, sepse ky tjetri e ka në dorë atë që t’i dëshiron të

¹ E shënon Ebu Daudi (4726), Ibn Ebi Shejbe në “El Arsh” (f.56 nr. 11), Ibn Huzejme në “Et-Teuhid” (1/239 nr. 147).

arrish, edhe ai që ndërmjetëson nuk mund të jetë i dobishëm vetëm se nëpërmjet një tjetri.

Për Allahun e Madhëruar nuk duhet që të mendohet kështu, sepse ky është mendim i keq për Atë. Pra, nuk bën që Allahun ta bësh ndërmjetësues për asnjë krijesë, sepse Allahu i Lartësuar është Ai që zotëron çdo gjë. Ta bësh Allahun ndërmjetësues është kur një njeri e do Allahun e Lartësuar që të ndërmjetësojë tek një njeri tjetër, e kjo bie në kundërshtim me teuhidin. Kjo është fjalë dhe vepër që bie në kundërshtim me madhërimin e Allahut të Lartësuar, madhërim që njeriu e ka detyrim ta bëjë. Prandaj e ka sjellë Shejhu (Allahu e mëshiroftë!) hadithin e Xhubejr Ibn Mutimit.

Argumenti për këtë është fjala e beduinit që i tha Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) “Prandaj kërkoji Zotit tënd të na sjellë shi. Ne i kërkojmë Allahut të ndërmjetësojë tek ti dhe të kërkojmë ty të ndërmjetësosh tek Allahu”. Ne kërkojmë ndërmjetësues Allahun, pra e bëjmë Allahun e Lartësuar ndërmjetësues për ne tek ty, me qëllim që ti të lutesh. Allahu i Lartësuar është Mbreti, i Gjalli i Cili nuk vdes, i Vërteti. Krijesat janë në dorën e Tij, Ai i drejton si të dojë. Pozita e Allahut është shumë më e madhe, e nuk i kërkohet që Ai të ndërmjetësojë tek asnjë nga krijesat e Tij, por njeriu kërkon ndërmjetësim tek ndonjë njeri tjetër për ndonjë nevojë të tijën. Allahu është Ai që zotëron gjithçka, në dorën e Tij janë pushteti i tokës dhe i qiejve, në dorën e Tij janë magazinat e çdo gjëje: “Nuk ka asnjë send që të mos gjenden tek Ne thesaret e tij; por prej tij Ne japim me masë të caktuar”². Njerëzit janë ata që kanë nevojë për Allahun dhe pozita e Allahut është me e madhe nga kjo, sepse krijesat janë të ulëta, të papërfillshme, krahasuar me Allahun e Lartësuar. Për këtë, (Paqja e Allahut qoftë mbi të!), kur beduini tha “Ne i kërkojmë Allahut të ndërmjetësojë tek ti, dhe të kërkojmë ty të ndërmjetësosh tek Allahu”, Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) tha: “Subhanallah, Subhanallah!”, për ta dëlirësuar, për ta madhëruar dhe për të larguar nga Allahu çdo përshtkrim të keq apo çdo mangësi dhe nga çdo lloj mendimi i keq.

“Vazhdoi të thoshte “Subhanallah”, derisa ajo u duk në fytyrat e shokëve të tij”. Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) vazhdoi kështu për një kohë të gjatë, duke larguar nga Allahu i Lartësuar çdo të metë dhe mangësi, për arsye se Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) mërzitej shumë për Allahun e Lartësuar. Askush nuk e njihte Allahun e Lartësuar më shumë sesa Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) dhe askush nuk kishte dije për Allahun sesa Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!).

² EL-HIXHR : 21

“Pastaj tha: “I mjeri ti! A e di ti kush është Allahu? Me të vërtetë, pozita e Allahut është më e madhe. Nuk i kërkohet Allahut që të ndërmjetësojë tek asnjë nga krijesat e Tij”.

Kush i di emrat e bukur të Allahut të Lartësuar dhe atributet të cilat i meriton Ai, nuk i shkon në mendje dhe as nuk e imagjinon që të mendojë keq për Allahun e Lartësuar apo ta përshkruajë Atë me mangësi.

Ky kapitull dhe ata para tij tregojnë se besimtari duhet të jetë i ruajtur nga shprehjet dhe mendime të këqija për Allahun e Lartësuar. Ai nuk duhet të shprehë gjëra që e ulin pozitën e Allahut në Rububijen e Tij. I Lartësuar dhe i pa të meta është Zoti ynë, Zoti i Gjithësisë!